



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KORPORATA ELEKTROENERGJITIKO SHQIPTARE

RELACIONI TEKNIK


Baza ligjore

VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

Ligji nr. 10440, date: 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"

PROJEKTI

**“REHABILITIMI I GALERISË SË PJERRËT NE HEC KOMAN F.V
DEKOVILI I RI DHE RIKONSTRUKSION I SHESHIT MES GALERISË
SË PJERRËT DHE SHPATIT TË DJATHTË NË DIGËN E KOMANIT”**



“KLODIODA” sh.p.k

SHKURT 2022

Përmbajtja

- a) Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar
- b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit; d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit
- f) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji
- g) Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës
- gj) Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon perzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjise që do të përdoret
- h) Te dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm të energjise, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

i) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

j) Informacion për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për projektin në përputhje me përcaktimet e bera në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licensimin e projektit

k) Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar në përputhje me përcaktimet e bera në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin / licensimin e projektit

a) Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar

KESH sh.a është prodhuesi publik me i madh i energjise elektrike ne Shqiperi. Duke pasur ne funksionim afro 79 % te kapaciteteve prodhuese ne vend, KESH sh.a furnizon rreth 75 % te kerkeses per energji elektrike te klienteve tarifore si dhe sigurin energjine e nevojshme per mbulimin e humbjeve ne sistemin e transemitimit.

KESH sh.a në kuader te ndryshimeve ne sektorin energjistik, hapjes se tregut te energjise dhe integritimit rajonal te sistemit ka vleresuar si domosdoshmeri kerkesat per modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve teknike dhe menaxhuese te shoqerise.

Misioni i KESH sh.a është:

- Plotesimi i kerkeses se vendit per energji elektrike me kosto sa me te ulet duke shfrytezuar me efektivitet burimet hidrike ekzistuese dhe duke zhvilluar burime te reja;
- Garantimi i jetegjatesise dhe sigurise se veprave nepermjet admnistrimit te kujdesshem. Mirembajtjes dhe permiresimti teknologjik te tyre;
- Minimizimin e ndikimit mjedisor dhe rritja e pergjegjshmerise sociale te shoqerise

Ndertimi i galerive te çimentimit dhe kontrollit u realizuar ne vitin 1984. Kjo galeri sherben per kontroll-monitorimin e perdes se thelle te çimentimit dhe ne te jane instaluar paisjet e kontrollit te ekranit betonarme te diges. Paisjet jane vendosur ne pjese te ndryshme te galerises se pjerret (çimentimit dhe kontrollit). Ne fund te Galerise, ne pjesen horizontale te saj, ne anen e djathte te tyre, ndodhen pompat e drenazheve qe sherbejne per largimet e ujrave te filtruara te cilat kontrollohen dhe monitorohen vazhdimisht.

Per sa me siper dhe ne përputhje me programin ekonomik, KESH sh.a kërkon të realizojë projektin e zbatimit, preventivin dhe vleresimin e kostove per kryerjen e punimeve në objektin:

“Rehabilitimi i Galerise se Pjerret ne HEC Koman, F.V. Dekovili iri dhe Rikonstruksion i Sheshit mes Galerise në Digën e Hec Koman”

Bazuar në Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", si dhe të "Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 147, datë 18.03.2004, KESH sh.a, si shfrytëzuesi i këtij objekti, është përgjegjësi kryesor për sigurinë e digës dhe nënobjekteve të tjera që lidhen me të dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundëshme që mund të ndodhin.

Qëllimi dhe Objektivat e Ndrehyrjes

Galeria e Pjerret dhe Sheshi ne krah te saj jane pjese integrale e HEC KOMAN. Qellimi dhe objektivi i kesaj Kontrate eshte realizimi i nje projekti zbatimi, i cili ka synim permiresimin e infrastruktures operuese ne galerine e monitorimit dhe te shehsit ne ane te saj.

Realizimi dhe zbatimi i këtij projekti, do të ketë objektive përmirësimin e kushteve teknike edhe rritjen e sigurisë gjatë operimit si dhe rritjen e jetëgjatësisë së veprës në teresinë e saj.

Ky projekt do të bëjë të mundur reabilitimin e sheshit në krah të galerisë duke e bërë atë funksional dhe eficient.

Gjithashtu ky projekt synon reabilitimin e Galerisë së pjerret në teresi si dhe montimin brenda saj, të një Dekovili të Ri

b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.

Pozicioni i Objektivit

Zona ku është ndërtuar HEC Koman, sipas klasifikimit gjeografik të vendit tonë, bën pjesë në Krahinën e Alpeve Shqiptare (pjesa jugore e saj). I tërë segmenti shtrihet në një terren malor dhe të zhveshur.

Koordinatat Gjeografike brenda të cilave shtrihet objekti janë:

Gjerësi Gjeografike $42^{\circ} 06' 00''$ - $42^{\circ} 07' 00''$

Gjatësi Gjeografike $19^{\circ} 49' 00''$ - $19^{\circ} 50' 00''$

Koordinatat shtetërore brenda të cilave shtrihet objekti janë:

Gjerësi 46 63 450 – 46 64 550m

Gjatësi 44 02 020 – 44 03 020m




Figura 1. Pozicioni i sheshit qe do te rikostruohet

Gjendja Ekzistuese e Objekteve

H/C Koman në veri të Shqipërisë i ndertuar në lumin Drin ka filluar punen në vitin 1985. Ndertesa e Çentralit të HEC Koman ndodhet në bregun e djathtë të rrjedhes, pranë fundit të digës së Komanit. Gjithashtu në krahun e djathtë të biefit të sipërm të digës së Komanit ndodhet Vepra e marrjes së ujit dhe Hyrja e tuelit Nr.4 të shkarkimit.

Shkarkuesit e HEC Koman përbëhen nga dy tunele të veshur me beton të cilët ndodhen në bregun e djathtë dhe të majtë të lumit Drin. Këto dy tunele, të përcaktuara si tuneli i shkarkimit Nr.3 dhe Nr.4, kanë karakteristika të përgjithshme shumë të ngjashme siç janë vepra e marrjes në formën e kullës betonarme ku janë janë vendosur portat radiale të punës dhe portat e mirmbajtjes. Sistemi i portave është i njëjtë për të dy tunelet e shkarkimit.

Vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit Nr.3 është e aksesueshme nga kurora e digës përmes një urë të varur metalike ndërsa vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit Nr.4 është e aksesueshme përmes tunelit që ndodhet në anën e djathtë të kurores së digës. Prandaj portave të hyrjes të tunelit të shkarkimit Nr.4 ndodhen edhe portat e vepres së marrjes së ujit për Turbinat e HEC Koman.

Objektet për të cilat kërkohet rehabilitimi i plotë i tyre, janë pjesë e veprave të hidrocentralit të Komanit si më poshtë:

- a) Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)
- b) Sheshi midis Galerisë së Pjerret dhe shpatit të djathtë të HEC Koman.

- ***Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)***

Siç e përmendëm edhe më lart, kjo galeri është ndërtuar në vitin 1984. Ajo është një strukturë betonale e vendosur mbi digën e HEC Koman dhe ka një formë rrethore me diametër të brendshëm 4.5m.

Galeria ka një gjatësi prej 250m (në plan) nga të cilat 232 janë në pjesën e pjerret të saj dhe 18m në pjesën horizontale të saj.

Në planin horizontal Galeria në distancë 59m nga fillimi i saj ka një këthëse prej 32 grade në drejtim të lindjes.

Në planin vertikal, galeria në pjesën e parë me një gjatësi prej 55m ka një pjerresë në rënie prej 31 grade, ndërsa në pjesën tjetër pjerresia vazhdon me 26 grade.

Galeria ka një organizim të tillë:

Në qendër të saj është pozicionuar një kanal për kullimin dhe largimin e ujërave me thellësi mesatare 45cm dhe gjatësi 50cm.

Në të dy anët e kanalit janë ndërtuar simetrikisht shkallare me gjatësi 1m, për lëvizjen e kembësoreve përgjatë galerisë.

Në dy anët e shkallareve janë ndërtuar dy platforma të pjerreta betoni mbi të cilat janë vendosur shinat e dekovilit ekzistues.

Në dy faqet e galerisë janë vendosur kabllot që lidhin fundin e galerisë (zonën e kontrollit me pjesët e tjera të HEC Koman).

Në faqen e majtë të Galerisë është vendosur sistemi i ndriçimit. Sistemi i ndriçimit është realizuar me ndricues neoni tubular 2x36w. Ndricimi është i amortizuar dhe demtuar në disa zona, duke krijuar zona të erreta përgjatë galerisë. Për më tepër ky sistem konsiderohet i vjetër dhe jo eficient. Demtime të sistemit të ndriçimit vërehen si në ndricues ashtu edhe në elementet e rrjetit (tuba, percjelles, kuti shpërndarëse, grapeta etj).

Ne hyrje te Galerise jane vendosur paisjet e komandimit dhe funksionimit te Dekovilit ekzistues si dhe nje dhome komandimi dhe kontrolli.

Ne pjesen fundore te Galerise, ate horizontale jane vendosur pompat e largimit te ujrave dhe nje dhome ku jane montuar paisjet e monitorimit dhe Kontollit.



Figura 2. Foto te Galerise Gjendja Ekzistuese

- ***Sheshi midis Galerise se pjerret dhe shpatit te dhjathte te Diges se HEC Koman***

Ky shesh shfrytezohet nga Reparti Hidroteknik per punime mirembajtjeje dhe pastrimi te hidrocentralit. Ne ane te diges akumulohen mbeturina te shumta urbane dhe pyjore, te cilat vijne nga perrenjte malore te pellgut ujembledhes te Liqenit te Komanit. Mbeturinat akumulohen ne skarpaten e diges. Rehabilitimi i ketij sheshi me qellim krijimin e nje hapsire pune per vincin do beje te mundur evadimin e mbeturinave nga Liqeni i Komanit.

Ky shesh dikur ka qene i asfaltuar. Shtresat asfaltike dhe e tere paketa e shtresave ka degraduar pothuaj teresisht.

Ne hyrje te sheshit, ne anen e djathte eshte Godina e hyrjes se Galerise se Pjerret. Ndersa ne anen e majte eshte ndertuar nje mur prites, i cili sherben per pritjen e materialeve inerte qe shkeputen nga faqja e shpatit te diges. Te dy keta elemente krijojne nje hinke te ngushte ne hyrje te sheshit.

Aktualisht hyrja e vincit per shkak te permasave te tij, ne kete shesh eshte i pamundur dhe pastrimi i liqenit behet nga kreshta e Diges se Komanit, gje e cila per shkak te distances behet me shume veshtiresi.



Figura 3. Foto te Sheshit Gjendja Ekzistuese

c) Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Objekti që është marrë në studim ndodhet në Fshatin Koman. HEC i Komanit ndodhet në pjesën veri-lindore të Fshatit Koman një nga veprat me të mëdha hidroenergjitike në Shqipëri.

Fshati i Komanit është pjesë e Njesisë Administrative Temal, pjesë e bashkisë së Vaut Dejes Bashkia e Vau Dejes është pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distancë 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Aeroporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 468 km² ku 10 465 ha janë tokë bujqësore.

Bashkia Vau Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Shkodrës, në lindje me Bashkinë Fushe-Arrez ndërsa në jug me Bashkitë Pukë dhe Lezhë.

Ajo përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 50 130 banorë, konkretisht: Vau Dejes me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnele me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë. Me ndarjen e re administrative në vitin 2015, Bashkia ka nën administrimin e saj qytetin e Vau Dejes dhe 47 fshatra.

Njësitë Administrative (Rajonet) ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas shtrirjes gjeografike mbi komunitetin qytetar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe përgjigjen për sigurimin e veprimtarisë jetësore në territorin nën juridiksionin e tyre. Verifikimin në vend e mbi bazën e dokumentave të pakundërshtueshëm autentik të qytetarëve brenda 7 ditëve.

| Qarku | Qendra e Bashkisë | Njësitë administrative përbërëse | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre | Popullsia sipas Census 2011 | Popullsia sipas Regjistrimit Civil | Sipërfaqja KM ² |
|---------|-------------------|----------------------------------|--|-----------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| Shkodër | Qyteti Vau-Dejës | Vau-Dejës | Qytetet Vau Dejes, Fshatrat; Mjeda, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe | 30,438 | 50,042 | 468,00 |
| | | Bushat | Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten | | | |
| | | Vig-Mnele | Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig | | | |
| | | Hajmel | Fshatrat; Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë | | | |
| | | Temal | Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Klllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë | | | |
| | | Shllak | Fshatrat; Vukajak-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj | | | |

Figura 4. Njesite Administrative te Bashkise Vau-Dejes dhe Popullsia

Aktiviteti kryesor ekonomik është bazuar në bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogël dhe shërbimet. Bashkia Vau Dejës gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit të energjisë me hidrocentralin e Vaut të Dejes, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2. Në Bashkinë Vau Dejes ndodhet dhe Landfilli rajonal i Bushatit, si pike grumbulimi dhe perpunimi i mbetjeve për rajonin Shkoder-Lezhë.



Figura 5. Njesite Administrative te Bashkise Vau-Dejes te paraqitura ne harte

ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit

Objektet për të cilat kërkohet rehabilitimi i plotë i tyre, janë pjesë e veprave të hidrocentralit të Komanit si:

- Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)
- Sheshi midis Galerise se Pjerret dhe shpatit te djathte te HEC Koman.

1) Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)

Galeria e Çimentimit dhe Kontrollit është e ndërtuar ndërtuar në vitin 1984. Konturi i Galerise është një strukturë betonale e vendosur mbi digën e HEC Koman dhe ka një formë rrethore me Diameter të brendshëm 4.5m. Në qendër të saj është pozicionuar një kanal për kullimin dhe largimin e ujrave me thellesi mesatare 45cm dhe gjerësi 50cm. Në të dy anët e kanalit janë ndërtuar simetrikisht shkallare me gjerësi 1m, për levizjen e kembesoreve përgjatë galerise. Në dy anët e shkallareve janë ndërtuar dy platforma të pjerreta betoni mbi të cilat janë vendosur shinat e dekovilit ekzistues. Në dy faqet e galerise janë vendosur kablllo që lidhin fundin e galerise (zonën e kontrollit me pjesët e tjera të HEC Koman. Në faqen e majtë të Galerise është vendosur sistemi i ndriçimit.

Për rehabilitimin e galerise do të behen nderhyrjet:

- Do te cmontohen dhe hiqen te tera mekanizmat dhe paisjet e dekovilit te vjeter dhe do te largohen nga objekti.
- Do te cmontohen dhe hiqen te shinat qe kane sherbyer per levizjen e dekovilit te vjeter dhe do te largohen nga objekti
- Do te prishen te dy bankinat anesore prej betoni ku jane montuar shinat (shtresa e bere per nivelim)
- Do te behet prishja pjesore e shkalleve. Do te prishen ato shkalle qe kane demtime strukturore (si plasaritje, shkeputje etj)
- Do te behet pastrimi i kanalit nga mbeturinat dhe pastrimi i siperfaqes se betonit.
- Do te cmontohen tere kabllot e trasmetimit dhe furnizimit qe ndodhen ne anen e djathte te galerise.
- Do te behet pastrimi (zmerilimi) e siperfaqes se betonit (gjysma e djathte e galerise. Me ane te zmerilimit do te pastrohen tere mbetjet nga armatura e betonit. Gjithashtu do te priten tere kunjat e dala te hekurit te lena nga ndertimi.
- Do te behet montimi i linjave te reja te ndricimit te galerise.
- Do te behet montimi i kablllovet e trasmetimit dhe furnizimit.
- Do te cmontohen tere kabllot e trasmetimit dhe furnizimit qe ndodhen ne anen e majte te galerise dhe do te montohen ne anen e djathte te galerise.
- Do te behet cmontimi i ndricimit ekzistues, i cili ndodhet ne anen e majte te galerise.
- Do te behet pastrimi (zmerilimi) e siperfaqes se betonit (gjysma e majte e galerise). Me ane te zmerilimit do te pastrohen tere mbetjet nga armatura e betonit. Gjithashtu do te priten tere kunjat e dala te hekurit te lena nga ndertimi.
- Do te behet prishja e suvave ekzistuese ne sallen e montimit te makinerise se dekovilit dhe ne sallen e komandimit.
- Do te behet veshja e bazes se kanalit me nje shtrese betoni C25/30 me spesor 5cm. Siperfaqja do behet e lemuar. Shkallet e betonit do te vishen me nje shtrese betoni C25/30 me trashesi 5cm. Shkallet do te armohen me nje zgare hekur 10mm (sipas detajit perkates) Per lidhje do te inkastrihen fitila hekuri 12mm respektivisht dy cope per cdo shkalle. Siperfaqja e shkalleve do te realizohet e ashper per te shmangur rreshkitjen gjate levizjes (I ashtuquajtur beton me fshese).
- Do te behet montimi i bazamenteve per mbajtjen e shineve te reja te dekovilit.
- Me pas do te behet pastrimi me fshese me aspirim dhe lyrja me boje betoni ngjyre gri e hapur.
- Do te behet montimi indricuesve te galerise dhe venia ne pune e sistemit te ndricimit.
- Do te montohen shinat e reja te dekovilit.
- Do te vendoset korimano metalike pergjate galerise. Korimano do te vendoset ne anen e djathte te kanalit duke sherbyer njekohesiht si per mbajtjen e personave gjate ngjitje-zbritjes neper shkalle ashtu edhe si nje barriere mbrojtese midis pjese se levizjes se kembesoreve dhe pjeses ku leviz dekovili.
- Do te lihen disa hapsira 1.5-2m ne zonat ku parashikohet te kete ndalesa te dekovilit (stacione).
- Dhoma e montimit te mekanizmave te dekovilit do te shtrihet me beton C25/30 me t=8-10cm e perforcuar me hekur 10mm ne forme zgare 10x10cm.

- Do behet montimi i mekanizmave dhe paisjeve te dekovilit te ri.
- Do te behet montimi i paneleve elektrike.
- Do behet lysterja e sallave me boje hidromat.
- Do te behet testimi, kolaudimi dhe venia ne pune e dekovilit.

Pershkrimi i Seksionit terthor te Galerise.

Ne anen e majte saj (ne drejtimin zbritje) do te vendoset dekovili i ri. Shinat do te montohen mbi bazamente metalike te fiksuara ne prirxhaniere ne betonin ekzistues.

Kanali i kullimit te ujrave do te qendroje ne pozicionin aktual duke u riveshur ne baze dhe duke u mbuluar me zgare metalike te zinguar.

Shkallet ekzistuese ne anen e djathte te galerise do te rivishen me betonarme.

Ne anen e majte te kesaj shkalle do te vendoset nje korimano inoksi ose hekuri te zinguar.

Ne faqen anesore te djathte te galerise do te montohen kanalina metalike ne te cilat do te vendosen kabllot e transmetimit te fuqise dhe kabllot e komandimit.

Ne pjene djathtat lart (2.5m-2.7m lartesi) do te vendoset ndriçimi i galerise, pergjate gjithe gjatesise se saj.

Seksioni Tip i Galerise




Figura 6. Seksioni Tip i Galerise

2) Sheshi midis Galerise se pjerret dhe shpatit te dhjathte te Diges se HEC Koman

Ky shesh shfrytezohet nga Reparti Hidroteknik per punime mirembajtjeje dhe pastrimi te hidrocentralit.

Per rehabilitimin e sheshit do te duhen keto nderhyrje:

- Do te behet skarifikimi i shtresave ekzistuese rrugore (asfalto-beton, binder stabilizant)
- Do te behet prishja e murit te betonit ne hyrje te sheshit.
- Do te behet ndertimi i murit te ri te betonarmese (ne forme harku me afer shpatit.
- Do behet shtrimi me cakell makinerie i sheshit. Me kete shtrese do te behet nivelimi i pare.
- Do te behet shtrimi me beton C7/10 i sheshit me nje trashesi 10cm. Me kete shtrese do te behet nivelimi perfundimar baza per shtrimin perfundimtar te sheshit.
- Do te behet ndertimi i kanalait te ri ku kalojne linjat e trasmetimit dhe te furnizimit te galerise. Do te behet spostimi i kablllove
- Do te behet vendosja e zgares se hekurt D=12mm ne distance 12x12cm.
- Do te behet betonimi i sheshit me Beton C30/37 me trashesi 20cm. Siperfaqja e betonit do te realizohet me viaska per te shmangur rreshkitjet.




Figura 7. Seksioni Tip i Sheshit

d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/ përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Te gjitha detajet teknike janë përshkruar në projektin teknik dhe relacionin përkatës:

Proceset kryesore janë:

- Punime prishje muresh, bankinat anesore të Galerisë, prishje e pjesme të shkalleve.
- Skarifikim i shtresave
- Shtrimi me cakell të sheshit
- Ndërtimi i kanalit të ri ku kalojnë linjat elektrike
- Betonimi i sheshit
- Cmëntim dhe heqje mekanizmave të dekovilit
- Cmëntimi i kabllave të transmetimit dhe furnizimit me energji
- Montimi i linjave të reja të ndricimit
- Pastrimi dhe zmerilimi i sipërfaqes së galerisë
- Prishje e suvave ekzistuese në sallën e montimit të makinerive
- Veshje me beton të kanalit të galerisë dhe shkalleve
- Montimi i shinave të dekovilit dhe
- Vendosje e korimantëve metalikë përgjatë galerisë.
- Lyeje të sallave me bojë

Pajisjet dhe makineritë kryesore që do të përdoren gjatë fazës së rikonstruksionit janë ato që përdoren zakonisht në një aktivitet ndërtimi:

- Excavatore për gërmim;
- Kamione për transportin e materialeve që do të hiqen nga sheshi.
- Kamioncina për transport materialit ndërtimi dhe puntoreve
- Pompe betoni për hedhjen e betonit në objekt
- Pompe zhytëse
- Saldatrice

dh) Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja,

Hyrja ne sheshin e ndertimit

Gjate kohes se zbatimit te punimeve kontraktori duhet te organizoje punen per levizjen e njerezve ne sheshin e ku do te kryhen punimet. Sheshi i ndertimit do te jete i rrethuar dhe do kete tabela qe lajmerojne per kryerjen e punimeve ne shesh dhe galeri. Kontraktori nuk do lejoje hyrjen ne shesh te personave te paautorizuar. Kontraktori do te mbaje pergjegjesi per cdo problem qe mund te ndodhe ne sheshin e ndertimit. Kontraktori eshte pergjegjes per sigurine, qendrueshmerine si dhe kullimin e ujerave siperfaqesore ne sheshin e ndertimit.

Furnizimi me uje

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga uji i liqenit te Komanit nepermjet pompave dhe kalimit te tij me tubacion ne vendin e deshiruar. Kontraktori do te shtrije rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve.

Furnizimi me energji elektrike

Duke qene se objekti eshte ekzistues nuk eshte e nevojshme shtrimi i linjave te reja per furnizimin me energji gjate zbatimit te projektit, por perdorimi i atyre ekzistuese. Energjia elektrike qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor elektrik.

Mbetjet

Mbetjet inerte te cilat do te grumbullohen nga heqiet e shtresave te panevojshme, materiale inerte do te depozitohen ne vende te posacme te percaktuara nga njesia vendore. Materialet si shinat, dekovili ekzistues do te largohen dhe do te cohen ne nje pike te percaktuar nga KESH.

e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit

Rikonstruksioni i Sheshit dhe Rehabilitimi i Galerise parashikohet te zgjasin 6 Muaj pasi te merret aprovimi.

ë) Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit

Per kete aktivitet, nuk do te ngrihen objekte ndihmese.

f) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji

Lendet e para te perdorura jane kryesisht cimento, inerte te imta, inerte te trasha llaci i betonit, hekuri ,rere, gelqere, boje,uje. Keto lende do te sigurohen ne tregun e brendshem dhe te jashtem (EU).

Çimento

a.Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujerat e zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

b.Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore.

Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dysHEMEJA e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberitur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose

nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te riestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

Inertet

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohesh nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M250) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percakuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

| Masa e Sites | Perqindja qe kalon (peshe e thate) |
|-----------------|------------------------------------|
| 10.00mm | 100 |
| 5.00mm | 89 ne 100 |
| 2.36mm | 60 ne 100 |
| 1.18mm | 30 ne 100 |
| 0.60mm (600 um) | 15 ne 100 |
| 0.30mm (300 um) | 5 ne 70 |

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

Inertet e trasha

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

| Masa e sites | Perqindja e kalimit (ne peshe te thate) |
|--------------|---|
| 50.0 mm | 100 |
| 37.5 mm | 90 ne 100 |
| 20.0 mm | 35 ne 70 |
| 10.0 mm | 10 ne 40 |
| 5.0 mm | 0 ne 5 |

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

g) Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës

Projekti eshte rikonstruksion sheshi dhe reabilitim i galerise dhe nuk ka mbivendosje me projektet e tjera.

gj) Informacion per alternativat e marra ne konsiderate per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret

Nderhyrjet qe do te behen jane teresisht ne kuader te rikonstruksionit te sheshit ekzistues dhe galerise

h) Te dhena per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.

Furnizimi me uje

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga uji i liqenit te Komanit nepermjet pompave dhe kalimit te tij me tubacion ne vendin e deshiruar. Kontraktori do te shtriye rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve.

Furnizimi me energji elektrike

Duke qene se objekti eshte ekzistues nuk eshte e nevojshme shtrimi i linjave te reja per furnizimin me energji gjate zbatimit te projektit, por perdorimi i atyre ekzistuese. Energjia elektrike qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor elektrik.

i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Per zbatimin e ketij projekti nuk do te nevojitet ndertimi i kapanoneve apo rezidencave per arsye se eshte rikonstruksion dhe objektet jane ekzistuese.

j) Informacion per leje, autorizime dhe licenca te nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licensimin e projektit

Ky aktivitet sipas shtojces II te ligjit nr 10440, dt 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" i ndryshuar duhet ti nenshtrohet dhe te pajiset me vendim per miratim per VNM paraprake dhe nuk perfshihet ne listen e aktiviteteve qe duhet te pajisen me leje mejdisi.

k) Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin / autorizimin / licensimin e projektit

Nuk disponon ende.

Ky raport u hartua nga:

KLODIODA SH.P.K.

Ekspert Mjedisi: Ing. Najada Mustafaj